



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**

---

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Raport- Progresi i Komisionit European vlerëson si të kënaqshëm progresin në fushën e antitrustit dhe përqëndrimeve**

Komisioni European publikoi raportin e progresit për Shqipërinë, ku kapitulli 8 i kushtohet “Politikës së konkurrencës”. Në konkluzionet e Raportit shkruhet se “në përgjithësi, përgatitjet në fushën e antitrust-it dhe përqëndrimeve janë të kënaqshme”. Sa vijon Raporti i plotë për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore.

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës mori një vendim, në nëntor, për të siguruar një udhëzim për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale, në fushën e antitrust-it dhe përqëndrimeve. Autoriteti mori 34 ankesa, krahasuar me 19 të tilla në të njëjtën periudhë vitin e shkuar, gjë e cila çoi në hapjen e hetimeve në fushën e sigurimeve, shërbimit të transportit publik, sektorit të hidrokarbureve dhe tregut të transportit detar.

Autoriteti gjithashtu filloi dhe përfundoi hetimet mbi telefoninë, tregun e cigareve dhe shërbimeve të sigurimit privat. Ai nxorri 5 (pesë) vendime mbi marrëveshjet anti-konkurrese, 1 (një) vendim mbi abuzimet në pozitën dominuese, dhe 4 (katër) vendime që lejojnë bashkimet. Autoriteti gjithashtu, nxorri tre vendime në lidhje me vlerësimet e ankesave dhe përjashtoi një marrëveshje kufizuese. Ai miratoi 3 (tre) akte ligjore, nxorri 5 (pesë) rekomandime dhe nisi 9 (nëntë) procedura administrative. Në vitin 2013 nuk u vu asnjë gjobë, krahasuar me vitin 2012 kur ishin vënë 7 (shtatë).

Në qershor, Autoriteti i vendosi një gjobë një kompanie për vonesë të procedurave. Ai, gjithashtu, lëshoi disa rekomandime për rregullatorin (entin) e telekomunikacionit, Autoritetin e Komunikimit Elektronik dhe Postar, Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe për qeverinë në lidhje me dy konçesione. Për sa i përket çështjeve gjyqësore, Autoriteti i Konkurrencës humbi një çështje përpara Gjykatës së Shkallës së Parë, të cilin e apeloj. Shumica e gjobave që janë vënë më parë nga Autoriteti nuk kanë arritur të mbliidhen, duke qënë se shumë vendime të Apelit janë ende në pritje. Struktura e tij e re duhet të miratohet nga Parlamenti. Trajnimi i gjyqtarëve në lidhje me konkurrencën ka ende vend për përmirësim.

Në sektorin e ndihmës shtetërore, qeveria miratoi përbërjen e re të Komisionit të Ndhmës Shtetërore në shkurt. Në prill, qeveria miratoi 4 (katër) skema të ndihmës shtetërore për nxitjen e punësimit. Qeveria vazhdoi të lëshojë garanci për bankat e nivelit të dytë në emër të kompanisë së prodhimit të energjisë në pronësi shtetërore KESH, për shkak të vështirësive të fundit financiare. Ndhma shtetërore ishte € 143.8 milion në vitin 2013, dhe 6% më pak në vitin 2012, e përbërë kryesisht nga subvencionet, grantet dhe lehtësimet tatimore. Numri i ndihmave shtetërore është ende i ulët dhe nuk ka asnjë ndihmë nga autoritetet lokale. Stafi i Sektorit të Ndhmës Shtetërore është reduktuar në vetëm dy zyra.

### **Përfundime**

Në fushën e politikës së konkurrencës janë bërë disa përmirësime, kryesisht në fushën e antitrust-it dhe bashkimeve, ku Autoriteti i Konkurrencës vazhdon të rrisë numrin e vendimeve. Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e antitrust-it dhe përqëndrimeve janë të kënaqshme. Duhet ende veprime të tjera për të përforcuar kapacitetin administrativ dhe pavarësinë operacionale të institucionit të ndihmës shtetërore. Rregullat e ndihmës shtetërore duhet të vendosen në mënyrë efektive dhe legjislacioni duhet të jetë në të njëjtën linjë me legjislacionin e BE-së. Në një vështrim të përgjithshëm, përgatitjet në fushën e ndihmës shtetërore janë në fazat e para.